

RREGULLORE PËR PJESËMARRJEN NË DAJTI SUMMER CAMP

Të dashur prindër dhe fëmijë,

Kampi ynë veror ofron një ambient të sigurt, edukues dhe argëtues për fëmijë të moshës 9–14 vjeç, ku natyra, shoqëria dhe zhvillimi personal bashkohen në një përvojë unike. *Kampi zhvillohet në Parkun Kombëtar të Dajtit tek Dajti Paradise*. Për një eksperiencë sa më të sigurt, të këndshme dhe të organizuar për të gjithë, ju lutemi lexoni me kujdes këtë rregullore:

PAGESA & ÇMIMET

- **Tarifa javore e kampit: 25,000 Lekë përfshin:**
 - Transport vajtje-ardhje nga Tirana në Dajt
 - Akomodim 6-ditor (e hënë – e shtunë)
 - Ushqim i plotë: 3 vakte + 2 zemra çdo ditë
- **Paketa e regjistrimit (vetëm një herë): 5,000 Lekë përfshin:** uniformën e kampit, çantën dhe kapelet
- **Pagesa bëhet paraprakisht çdo javë.**

AKOMODIMI DHE HIGJIENA

- Fëmijët akomodohen tek Dajti Paradise në dhoma të pastra, të sigurta dhe të pajisura me sistem ventilimi dhe kondicionimi.
- Dhomat ndahen sipas gjinisë: **vajzat dhe djemtë qëndrojnë në dhoma të veçanta.**
- Pastrohen çdo ditë nga stafi i mirëmbajtjes dhe inspektohen rregullisht për higjienë maksimale.
- Pranë çdo ndërtese banimi ndodhen tualete dhe dushe me ujë të ngrohtë.

SIGURIA DHE MBIKËQYRJA

- Kampi ofron **kujdes të përhershëm nga edukatorë të trajnuar dhe staf me përvojë**, të pranishëm 24/7.
- Ka gjithashtu **personel shëndetësor në vend** për çdo situatë emergjente.
- Në rast nevojë, kampi bashkëpunon me Qendrën Shëndetësore më të afërt dhe do të njoftojë menjëherë prindin.
- Të gjitha aktivitetet zhvillohen **nën mbikëqyrje të plotë** dhe sipas protokolleve të sigurisë.

TRANSPORTI

- Transporti organizohet me autobusë të licencuar dhe të pajisur me sigurime të nevojshme.



- Nisja bëhet çdo të hënë nga Tirana në një pikë të përcaktuar, dhe kthimim nga Dajti Paradise çdo të shtunë në mesditë.
- Prindërit informohen çdo javë për oraret dhe detajet logjistike.

USHQIMI

- Fëmijët do të kenë ushqim të balancuar dhe të kontrolluar: mëngjes, drekë, darkë + dy vakte të lehta (zemra).
- Dieta speciale për fëmijë me nevoja ushqimore të veçanta mund të mundësohet me njoftim paraprak.

TELEFONAT & MJETET ELEKTRONIKE

- Për të nxitur ndërveprimin, lojërat dhe lidhjen me natyrën, përdorimi i telefonave do të lejohet vetëm në orare të caktuara, nën mbikëqyrjen e stafit.

PAJISJET E NEVOJSHME

- Uniforma e kampit, çanta dhe kapelet janë të detyrueshme dhe jepen në ditën e parë të kampit.
- Prindërit do të marrin një **listë të detajuar me çfarë duhet të sjellin fëmijët** për kampin (rroba, këpucë, pizhama, produkte higjienë etj.)

KOMUNIKIMI ME PRINDËRIT

- Prindërit informohen çdo ditë me **fotografi, video dhe njoftime** për aktivitetet përmes grupeve të mbyllura online.
- Në çdo moment, prindërit mund të kontaktojnë me koordinatoren e kampit për çdo pyetje ose nevojë.

SJELLJA & RREGULLAT E BRENDASHME

- Respekti ndaj stafit, shokëve dhe natyrës është detyrim i çdo pjesëmarrësi.
- Sjelljet agresive, mungesa e respektit ose thyerja e rregullave do të çojnë në njoftimin e menjëhershëm të prindërve dhe, në raste të veçanta, largim nga kampi pa rimbursim.

LEJE PËR FOTOGRAFI / VIDEO

- Kampi dokumenton momentet më të bukura për t'i ndarë me prindërit dhe për promovim.
- Prindërit plotësojnë paraprakisht lejen për përfshirjen e fëmijës në foto/video publike.